

Shtojca 2

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

(Sipas natyrës)

31 Dhjetor 20XX

(Monedha __)

Zërat e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve	Përshkrimi i ngjarjeve dhe transaksioneve që përfshihen në zërat përkatës
Shitjet neto	<i>Të ardhurat e përftuara nga shitja e produkteve, mallrave dhe shërbimeve gjatë periudhës kontabël</i>
Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	<i>Të ardhurat që përftohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike, duke përfshirë fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale ndryshimet në llogaritë/kërkesat e arkëtueshme dhe detyrimet për t'u paguar furnitorëve (nëse rezulton një humbje neto, ajo njihet në zërin "Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit")</i>
Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces	<i>Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe punës në proces, ku pakësimet e pozicioneve njihen si shpenzime dhe rritjet e pozicioneve si pakësim i shpenzimeve</i>
Puna e kryer nga njësia ekonomike raportuese për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar	<i>Materialet dhe shërbimet që janë përdorur në prodhimin e aktiveve afatgjata dhe që janë njohur si shpenzim në një zë tjetër të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, njihen si një pakësim i këtij zëri</i>
Mallrat, lëndët e para dhe shërbimet	<i>Kostoja e mallrave, lëndëve të para dhe shërbimeve të konsumuara në prodhim për veprimtaritë parësore (për shembull, veprimtaritë e prodhimit ose shitjeve)</i>
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	<i>Kosto e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, të blera për qëllime administrative dhe të tjera që nuk lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë parësore (për shembull, kostoja e shërbimeve për mbajtjen e llogarive, shpenzimet për këshillim, shpenzimet për zyrën, sigurimet e jetës ose pronës, shpenzimet e reklamave, shpenzimet e kërkim zhvillimit, etj.) Gjithashtu, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit, duke përfshirë humbjen nga shitje afatgjata materiale, shuma e gjobave dhe ndëshkimeve, si dhe ndryshimet në vlerën e kërkesave për t'u arkëtuar dhe detyrimeve ndaj furnitorëve (nëse rezultati është një fitim neto, ai njihet në zërin</i>

	<i>"Të ardhura të tjera nga veprimtari shfrytëzuese")</i>
Shpenzime të personelit	
<i>Pagat</i>	<i>Pagat, shpërblimet, pagat për lejet vjetore, festat dhe kompensime të tjera monetare e jomonetare gjatë periudhës kontabël, pavarësisht nga fakti nëse ato janë paguar ose jo</i>
<i>Shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i>	<i>Sigurimet shoqërore dhe primi i sigurimit për papunësinë, paguar nga njësi ekonomike raportuese, mbi pagesat e paraqitura në zërin e mësipërm</i>
Amortizimi	<i>Shpenzimi i amortizimit të aktiveve afatgjata për periudhën</i>
Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit	
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare	
<i>Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit mbi huat bankare dhe hua të tjera me interes</i>
<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi</i>	<i>Fitimi/humbja nga ndryshimi i kursit të këmbimit të kërkesave për t'u arkëtuar dhe detyrimeve për t'u paguar (për shembull, huat e dhëna dhe të marra) në monedhë të huaj e që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese</i>
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare	
Fitimi (humbja) para tatimit	
Shpenzimet e tatimit mbi fitimin	
Fitimi (humbja) neto e vitit financiar	